



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 mars 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1713_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47, Nenit 48 dhe 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 dhe Nenit 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Metodologjinë për Strukturën Tarifore sipas Nenit 20 të Rregullës ZRRE/Nr. 15/2017 për të Hyrat e FSHU;
- Vendimin V_1707_2023 të datës 23 mars 2023 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU);
- Propozimin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU), për tarifën e Furnizuesit me Shërbim Universal, të dërguar më datë 27 mars 2023 në ZRRE.

në seancën e mbajtur më 30 mars 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN** - Tarifën me Pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II.** Tarifën me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), janë paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tabela: Tarifat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementë Tarifor	Njësia	Koha gjatë	Tarifa
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.91
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.75
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.68
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.65
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.77
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.33
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.82
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.61
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.26
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.77
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.43
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.72
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.73
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.77
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.43
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	10.19
			€/kWh	Tarifë e Lartë	12.36
				€/kWh	Tarifë e Ulët
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.79
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.34
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	14.45
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.81
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e vetme	6.13
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	11.60
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	7.79
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.70
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	10.66

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
 Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
 Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\phi) < 0.95$

III. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), nga data 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- o Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), me datë 5 dhjetor 2022 ka dorëzuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm në ZRRE.
- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11 janar 2023 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). ZRRE sipas njoftimit ka theksuar se, në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ka analizuar të dhënat

aktuale të operatorëve dhe bazuar në ato ka konstatuar se është arritur pragu i materialitetit i përcaktuar me Rregullat për të Hyrat për operatorët e rregulluar, përkatësisht janë plotësuar kushtet për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ku shkaktarët kryesor për tejkalimin e pragut të materialitetit janë bazuar në mungesën e të hyrave të realizuara dhe të kostove më të larta të energjisë me shumicë krahasuar me ato të parashikuara.

- Për shkak se implementimi i procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të jetë e njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore, ZRRE ashtu siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të FSHU-së ka marr parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë prapun e materialitetit) në përshtatjet e rregullta vjetore .
- ZRRE me 26 maj 2022 ka iniciuar procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e tretë rregullative 2023-2027 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, i cili është trajtuar paralelisht me procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm.
- ZRRE ka ndërmarr të gjitha këto veprimet në harmoni me legjislacionin për sektorin e energjisë ashtu që të mos cenohet siguria e furnizimit me energji elektrike.
- ZRRE me datë 23 janar 2023 nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka pranuar aplikacionin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2023.
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ-Përshtatja vjetore për FSHU për vitin 2023.
- Raporti Konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së, për të Hyrat e Lejuara Maksimale për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike ashtu që të mos cenohet siguria dhe vazhdueshmëria e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët, si dhe raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit ndaj Raportit Konsultativ lidhur me HLM të PRR3, dhe atë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sindikata e pavarur Elektrokosova KESCO, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Furnizuesi me Shërbim Universal – KESCO.
- Furnizuesi me Shërbim Universal – KESCO ka dorëzuar komentet me datë 03 mars 2023, ndaj Raportit Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike në kuadër të PRR3.
- ZRRE i ka trajtuar komentet e të gjitha palëve të interesit dhe të FSHU , të njëjtat i ka përfshirë në raportin përfundimtar për HLM për FSHU të cilin e ka publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së.
- Bordi i ZRRE-së, pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, me datë 23 mars 2023 përmes Vendimit V_1707_2023 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU), që do të mblidhen nga FSHU përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.
- Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për periudhën relevante tarifore të vitit 2023 do të jenë 398,442,759 €.

- FSHU sipas këtij Vendimi është udhëzuar t'i përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave të rregulluara me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- ZRRE më datë 27 mars 2023 ka pranuar nga FSHU, propozimin për Tarifatat me pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.
- Propozimi i FSHU-së për tarifatat e konsumatorëve me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, është i bazuar në vendimin e ZRRE-së, për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, V_1707_2023 të datës 23 mars 2023.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifatat e Furnizuesit me Shërbim Universal nga FSHU, ka vlerësuar që propozimi i FSHU-së, nuk kanë reflektuar drejtë nivelin e arsyeshëm të kostove të shërbimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe do të paraqiste ndër-subvencionim ndërmjet grupeve tarifore. Po ashtu FSHU dhe nuk ka ofruar argumente të bazuara dhe të dhëna analitike në lidhje me propozimin e saj.
- Duke qenë se tarifatat e propozuara nga i licencuari FSHU nuk kanë ndjekur parimet e vendosura në Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU), konkretisht me Kreun VII - Metodologjia për Strukturën Tarifore, ZRRE ka ri-kalkuluar tarifatat me pakicë në pajtueshmëri me Rregullën ZRRE/Nr.15/2017 për të Hyrat e FSHU-së.
- Tarifatat me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal të përcaktuara nga ZRRE reflektojnë kostot e përgjithshme të furnizimit të konsumatorëve me të drejtë të Furnizimit të Shërbimit Universal, ku përfshihen kostot e energjisë elektrike me shumicë, kostot e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes dhe kostot direkte të FSHU-së.
- Tarifatat me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal të përcaktuara nga ZRRE janë të kategorizuara sipas grupeve tarifore në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, përkatësisht me Nenin 20 të Metodologjisë për Strukturën Tarifore, mbi bazën e së cilës mundësohet që secili grup tarifor të bartë kostot e shkaktuara.
- Tarifatat me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal inkurajojnë shfrytëzimin eficient të energjisë, përmirësojnë ribalancimin e tarifave ndërmjet grupeve të konsumatorëve.
- ZRRE në propozimin përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU ka përfshirë edhe vlerën e subvencionit prej 19.5mil€, ndikimi i të cilave është reflektuar në tarifatat e energjisë elektrike me pakicë.
- Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit të FSHU-së për tarifatat me pakicë, vlerësimit të raporteve relevante, dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi V_1489_2022 i datës 08 shkurt 2022.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:



Ymer Fejzullahu, kryesues



Lutfije Dervishi, anëtar



Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO SH.A),
- KEDS,
- KOSTT, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.